

EQD/EDNJ PËR DREJTORË



Ndërgjegjësimi

Demokracia është më shumë se një marifet!

Përgatitja

Demokracia në shkollën time

Veprimi

Demokracia: Fillo tash!

PJESËMARRJA



Pjesëmarrja

Drejtoret dhe stafi i tyre e dinë që institucionet dhe parimet e demokracisë përcaktohen me kushtetutën e tyre kombëtare dhe përfshihen në kurrikulat e tyre. Prandaj, ato nuk janë të negociueshme. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të kenë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje që ndikon në shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Kjo e drejtë është mishëruar në nenin 12 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, e cila kërkon që pikëpamjet e fëmijëve dhe të rinjve të dëgjohen “në të gjitha çështjet që prekin fëmijën”.

Parimet themelore të demokracisë përfshijnë të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve. Për të mbrojtur pakicat dhe të dobët e të lëndueshmit, për shembull fëmijët dhe të rinjtë, ekzistojnë kufij për atë që deri ku mund të vendosë shumica. Në një sistem demokratik, të gjitha ligjet dhe vendimet duhet të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe fëmijëve. Ky është një nga parimet më të rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë duhet t'i mësojnë në shkollë, si në teori ashtu edhe në praktikë. Prandaj, përveç plotësimit të kërkesave kurrikulare në edukimin për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, shkollat duhet të ofrojnë përvoja të përshtatshme të jetës reale për nxënësit e tyre në komunitetin shkollor.

Mirëpo, Si mund të bëhet kjo?

Objektivat e këtij materiali për drejtoret që për temë ka demokracinë dhe pjesëmarrjen në shkolla janë të ofrojnë ide për të promovuar pjesëmarrjen e nxënësve, prindërve, mësuesve dhe komunitetit në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes së shkollave të tyre me sugjerime, hapa praktikë dhe modele të praktikës më të mirë për udhëheqje demokratike.

Pjesëmarrja

Pse duhet të përpiqemi për demokraci?

Demokracia

“Demokracia është qeverisje nga njerëzit në të cilët pushteti suprem i është dhënë popullit dhe ushtrohet drejtpërdrejt prej tyre (demokracia e drejtpërdrejtë) ose nga agjentët e tyre të zgjedhur në një sistem zgjedhor të lirë (demokracia përfaqësuese).

Shtyllat e demokracisë:

- Sovraniteti i njerëzve
- Qeveria e bazuar në pëlqimin e të qeverisurve
- Rregulli i shumicës
- Të drejtat e pakicave
- Garantimi i të drejtave themelore të njeriut
- Zgjedhjet e lira dhe të ndershme
- Procesi i rregullt ligjor
- Kufijtë kushtetues për qeverinë
- Pluralizmi social, ekonomik dhe politik, përfshirë njohjen e organizatave të pavarura të shoqërisë civile
- Vlerat e bashkëpunimit, konkurrencës së ndershme dhe kompromisit.

Këshilli i Evropës (2016): [Competences for Democratic Culture. Glossary of key terms](#). (në anglisht)

Pjesëmarrja

Standardet aktuale demokratike shkojnë përtej demokracisë përfaqësuese klasike, ku roli kryesor i qytetarëve është t’u delegojnë me votim përfaqësuesve të tyre përgjegjësinë për hartimin dhe zbatimin e politikave publike, duke marrë trajtën e demokracisë pjesëmarrëse, ku institucionet publike janë në pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së mirë dhe qytetarët kanë legjitimitetin që të përfshihen në të gjitha fazat e ciklit të politikës publike.” Këshilli i Evropës (po aty)

Ky model ideal tregon se si intensiteti i pjesëmarrjes mund të ndryshojë nga 0 (joekzistuese) deri në nivelin 5 (autonomi e plotë).

1. Njerëzit nuk janë të informuar për një vendim që lidhet me ta. Nga ata pritët t’u nënshtrohen rregullave dhe t’i kryejnë urdhrat.
2. Njerëzit informohen për një vendim që lidhet me ta. Por ata nuk kanë asnjë shans të ndikojnë në të.
3. Njerëzit konsultohen. Por pozicioni i tyre nuk merret doemos në konsideratë në vendimet që lidhen me ta.
4. Njerëzit janë të fuqizuar. Pozicioni i tyre merret plotësisht në konsideratë në vendimet përfundimtare që lidhen me ta.
5. Njerëzit janë të pavarur. Ata marrin vetë vendime që lidhen me ta.

Në këtë model të pjesëmarrjes, informacioni është variabla kryesore në nivelin 1 dhe 2, dhe liria dhe barazia në nivelet 3 deri 5. Me fjalë të tjera, udhëheqja autoritare e shkollës do të rezultojë në pjesëmarrje të nivelit 1 ose 2. Në një komunitet demokratik të shkollës, nxënësit do të kishin mundësinë për të marrë pjesë në nivelet 3, 4 dhe, nëse është e mundur, në nivelin 5. Ajo që nuk tregon ky model, megjithatë, është që pjesëmarrja duhet të mësohet, dhe nxënësit duhet të zhvillojnë kompetenca për të kuptuar informacionin rreth çështjeve dhe vendimeve që merren rreth tyre.

Në shkollë, si edhe në shoqëri në tërësi, demokracia përballet me sfida të përfshirjes. Qytetarët kanë të drejta të barabarta, por ato janë të pabarabartë sa i përket nivelit të kompetencave dhe fuqizimit të tyre. Drejtorët dhe mësuesit e shkollës duhet të bëjnë përpjekje për t’i inkurajuar nxënësit më të rinj ose më të drujtur të marrin pjesë në vendimmarrje, si dhe t’i bëjnë nxënësit më të rritur dhe më dominues të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre.

Shqyrtimi i kujdesshëm dhe diskutimi

Në mënyrë ideale, ne duam që vendimet jo vetëm të jenë të drejta, por edhe të bazuara mirë dhe të shëndosha. Kjo kërkon shqyrtim të kujdesshëm nga njerëzit e përfshirë në një proces vendimmarrjeje. Ai zhvillon një arsyetim të plotë dhe shkëmbim të pikëpamjeve dhe argumenteve të ndryshme ose të diskutueshme. Pjesëmarrësit duhet të informohen mirë dhe të respektojnë rregullat procedurale në shqyrtime, në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje reciprokisht të pranueshme në vendimet e tyre.

Shqyrtimi i kujdesshëm ka të bëjë me argumentimin e kuptueshëm dhe logjik, shpalosjen dhe reflektimin mbi preferencat (personale), balancimin bashkëbisedues të interesave individuale me interesat e të tjerëve, orientimin drejt së mirës së përbashkët (solidaritetit), si dhe ndershmërinë dhe vërtetësinë.

Kjo përshkruan idealin për të cilin duhet të përpiqet një bashkësi demokratike, si në shkollë ashtu edhe në komunitet në tërësi. Në të dy nivelet, shqyrtimi i kujdesshëm duhet të mësohet përmes praktikës, megjithëse nivelet e kompetencave midis pjesëmarrësve do të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër, meqenëse koha është një burim i kufizuar në praktikën e përditshme, duhet të gjendet një ekuilibër midis shqyrtimit të thellë (kurdo që është e mundur) dhe diskutimeve të rregulluara në mënyrë më të rreptë (aq sa është e nevojshme).

Pse të përpiqemi për demokraci?

Pse duhet të përpiqemi për demokraci në shkollë dhe në shoqëri si tërësi? Shoqëritë e qeverisura në mënyrë demokratike janë më mirë në shumë aspekte të rëndësishme; megjithatë, ato gjithashtu duhet të përballen me dobësi të caktuara që paraqesin sfida për një komunitet demokratik shkollor.

Fuqitë

- **Drejtësia:** Meqenëse të gjithë qytetarët gëzojnë të drejta të barabarta të pjesëmarrjes, vendimet e marra nga shumica ka më shumë të ngjarë të pranohen nga pakica ("pëlqimi i humbësit").
- **Cilësia e vendimmarrjes:** Meqenëse të gjithë qytetarët, ekspertët dhe grupet e interesit mund të marrin pjesë në diskutim publik dhe vendimmarrje, dhe mediet e lira e mbajnë të informuar publikun, pikëpamjet e ndryshme dhe interesat e kundërta merren në konsideratë. Vendimet kanë më shumë të ngjarë të japin zgjidhje efektive dhe të pranuar gjerësisht për problemet dhe çështjet.
- **Paqja përbrenda dhe jashtë:** Komunitetet e qeverisura në mënyrë demokratike rrallë fillojnë një luftë, pasi qytetarët nuk do ta mbështesin një politikë të tillë. Ata janë gjithashtu më paqësorë dhe më pak të prirur ndaj dhunës si një mjet për të arritur një qëllim politik.
- **Angazhimi dhe përgjegjësia:** Qeveritë demokratike inkurajojnë qytetarët të identifikohen me komunitetin dhe të marrin përgjegjësi.

Dobësitë (sfidat)

- **Kompleksiteti:** Në shoqëritë moderne, shumë çështje janë bërë aq komplekse sa kërkohet një nivel i lartë ekspertize për t'i kuptuar ato dhe për të diskutuar masat për t'u marrë me to. Pjesëmarrja ka tendencë të bëhet sferë e qytetarëve më të informuar dhe ekspertëve.
- **Mundësitë e pabarabarta:** Rrjedh se qytetarët mund të gëzojnë të drejtat e barabarta të pjesëmarrjes, por në realitet mundësitë për të marrë pjesë janë shpërndarë në mënyrë jo të barabartë. Nëse lihet pa përcjellje, kjo çështje mund të çojë në irritim dhe zhgënjim me demokracinë nga ana e atyre qytetarëve që e gjejnë veten të përjashtuar.

Këto dobësi paraqesin sfida për shkollat dhe sistemin arsimor, pasi ato mbajnë çelësin për t'i adresuar këto probleme. Fuqizimi i qytetarëve të rinj për t'u përballur me çështjet dhe problemet e komuniteteve të tyre është strategjia më e mirë për ta përgatitur brezin e ri për të ardhmen, si dhe për ta forcuar demokracinë.

Kompetencat

Fuqizimi për demokracinë mbështetet në kompetencat e fituara. Ne i zhvillojmë kompetencat tona përmes praktikës, duke u marrë me situata ose probleme të reja. Kjo shpjegon pse mundësitë e të nxënësve që pjesëmarrja në një komunitet demokratik shkollor u ofron nxënësve janë kaq të rëndësishme. Modeli i kompetencave i Këshillit të Evropës bën dallimin midis katër dimensioneve të kompetencës - vlerave, qëndrimeve, aftësive dhe njohurive dhe të kuptuarit kritik.

- Vlerat përfshijnë “njohjen e qytetarisë aktive” dhe “mbështetjen për proceset dhe procedurat demokratike”, të cilat nxënësit mund t’i përvetësojnë përmes pjesëmarrjes aktive në jetën shkollore.
- Qëndrimet e respektit - ndaj një personi, një besimi ose një parimi - ose mendësia qytetare - “ndjenja e përkatësisë dhe e identifikimit me komunitetin” - mësohen jo përmes predikimit, por përmes përvojës personale dhe reflektimit. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme që ju dhe stafi juaj (shpresojmë edhe prindërit) të shërbeni si modele të mira të sjelljes.
- Aftësitë (shkathtësitë) përfshijnë aftësinë për të “ndërtuar konsensus dhe kompromis brenda një grupi”. Siç e dinë mësuesit, aftësitë duhet të fitohen përmes praktikës së përsëritur.
- Njohuria dhe të kuptuarit kritik “për mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëpunojnë qytetarët në shqyrtime publike dhe vendimmarrje” kërkon të nxënit përmes përvojës praktike dhe reflektimit në një klasë të EQD/EDNJ (Edukimi për Qytetari Demokratike/Edukimi për të Drejtat e Njeriut), por nuk mund të fitohet vetëm duke mësuar prej librit.

Këshilli i Evropës (2016): Kompetencat për kulturë demokratike: [Kompetencat për kulturë demokratike](#), f. 35 e tutje

Pjesëmarrja

Çfarë ka të bëjë demokracia me shkollën?

Qasja themelore, efektet, kompetencat, paradokset, kufizimet

a) Të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë

Demokracia mund dhe duhet të mësohet në moshë të re. Qasja e të nxëniet që ueb faqja jonë "Demokracia në veprim" e promovon mund të përmblihet me sa vijon:

- Ne duhet të mësojmë për demokracinë në mënyrë që të jemi në gjendje të jetojmë në demokraci
- Ne duhet të jetojmë në demokraci në mënyrë që të jemi në gjendje të mësojmë për demokracinë

Këto teza tregojnë për faktin se nga njëra anë, demokracia varet nga arsimimi që të mund të vihet në praktikë, dhe nga ana tjetër, të praktikuarit e demokracisë është çelësi për të mësuar rreth saj. Prandaj, arsimi duhet të sigurojë që të rinjtë të mësojnë për demokracinë nëse një shoqëri dëshiron të mbetet ose të bëhet demokratike. Meqenëse shkollat janë zyrtarisht përgjegjëse për edukimin e brezit të ri, ato duhet të praktikojnë demokracinë në mënyrë që të nxisin të nxëniet e nxënësve për demokracinë.

b) Efektet

Pjesëmarrja jo vetëm që nxit të nxëniet për demokracinë, por, siç tregojnë hulumtimet, gjithashtu ka një efekt pozitiv në shëndetin e nxënësve, të nxëniet e nxënësve dhe procesin mësimor në përgjithësi: Vlerësimi i rregullt i reagimeve të nxënësve për procesin mësimor dhe përfshirja e familjeve të nxënësve dhe komuniteteve në shkollim ka çuar në arritjet e përmirësuara të nxënësve dhe përgjithësisht në cilësi më të lartë të shkollave dhe procesit mësimor. Analiza e procesit mësimor nga këndvështrimet e ndryshme (nxënësit, mësuesit) është një mënyrë shumë efektive për ta përmirësuar atë. Për më tepër, pjesëmarrja e nxënësve ka treguar se ka efekte pozitive në vetëbesim, në marrëdhëniet nxënës - të rritur dhe nxënës - nxënës, si dhe në etosin e shkollës. Përfshirja e mësuesve ose nxënësve në reformat e shkollës ka çuar në rezultate premtuese.

c) Paradokset

Paradoksi institucional

Shkollat u nënshtrohen normave, vlerave dhe ligjeve të një shteti të caktuar. Ato kanë përgjegjësinë për edukimin e brezit të ri. Nxënësit nuk mund të zgjedhin të mos ndjekin shkollën, pasi shkollimi është i detyrueshëm. Prindërit e tyre duhet t'i dërgojnë ata në shkollë. Mësuesit nuk janë të lirë t'u mësojnë atë që duan; ata janë punësuar për t'u mësuar atë që shteti e ka përkrahur në kurrikula. Atyre u kërkohet t'i vlerësojnë nxënësit sipas arritjeve të tyre në lëndët e përcaktuara. Drejtorët janë punësuar për të siguruar që shkollat funksionojnë sipas ligjeve dhe rregulloreve zyrtare. Kështu që shkollat nuk janë vende ku njerëzit e lirë dhe të barabartë bashkëveprojnë për të arritur interesin e përbashkët. Marrëdhënia midis grupeve përcaktohet nga hierarkitë dhe mjetet e ndryshme për të ushtruar fuqi me qëllim të përgatitjes së brezit të ri për jetën moderne dhe vendosjen e tyre në pozicione të ndryshme, të pabarabarta brenda shoqërisë.


Paradoksi pedagogjik

Marrëdhënia mësues-nxënës pasqyron faktin që edukatorët me më shumë përvojë dhe njohuri ua bartin njohuritë dhe përvojën e tyre nxënësve të paditur dhe të papërvojë. Pabarazia midis mësuesit dhe nxënësit, si dhe midis prindit dhe fëmijës, përcakton nevojën për arsim, por gjithashtu paraqet një pengesë për praktikën demokratike.

d) Kujdes nga kufizimet dhe kurthet

- Filloni me veten! Zbuloni se cilat masa dhe ndryshime janë brenda mundësive tuaja personale. Ju përfaqësoni një model sjelljeje për shkollën tuaj. Vetëm nëse e demonstroi dhe e praktikoni demokracinë në veprim, mund të prisni praktika demokratike nga ana e mësuesve tuaj.
- A jeni vërtet i gatshëm t'u jepni zë anëtarëve të komunitetit të shkollës? Askush nuk dëshiron ta zbulojë se angazhimi dhe përfshirja e tyre ishte për asgjë. Në vend që të praktikoni një aktivizëm pseudodemokratik, preferohet që të merrni vendime mbi bazën e informacionit dhe t'i komunikoni ato në mënyrë transparente. Pseudodemokracia është kundërproduktive dhe priret ta minojë besimin në praktikën e mëtejshme demokratike.

- Edhe nëse siguron një mundësi të vërtetë dhe të ndershme për praktikën demokratike, mos prisni që njerëzit ta ndjekin atë menjëherë. Në të vërtetë, disa njerëz madje mund t'i rezistojnë asaj. Praktika demokratike është kërkuese dhe kështu kërkon durim nga të gjithë të përfshirët. Mos u dekurajoni. Vazhdoni! Në fund do të ia vlejë.
- Jini shumë të qartë për mundësitë brenda të cilave mund të merren vendime lirish dhe për kufijtë që nuk duhet të tejkalohen (p.sh. kufizimet buxhetore, ligji, të drejtat e pakicave, detyrimet dhe përgjegjësia juaj si drejtues i shkollës, konflikti i roleve).



Pjesëmarrja

Katër sferat e demokracisë pjesëmarrëse në shkollë

Mënyra se si veproni si drejtor është thelbësore për shndërrimin e shkollës suaj në një komunitet (më) demokratik. Nëse keni ndërmend ta inkurajoni pjesëmarrjen në shkollën tuaj, përfshini sferat kryesore të mëposhtme në planifikimin dhe veprimet tuaja.

Komunikimi

Dëgjoni në mënyrë aktive (Çfarë dëshiron vërtet të thotë dikush? Si mendon ai/ajo? Cilat janë nevojat e tij/saj? Si është perceptimi i tij/saj?) Bindni të tjerët përmes argumenteve logjike dhe të kuptueshme. Bëni pyetje dhe përgjigjuni pyetjeve hapur. Shpalosni dhe shpjegoni me ndershmëri dhe vërtetësi qëndrimet, supozimet, ndjenjat tuaja për çështjen për të cilën do të vendoset. Mblidhni informata kthyesë. Ofroni një sintezë të të gjitha pikëpamjeve të ndryshme (cili interes i përbashkët mund të gjendet duke marrë parasysh të gjitha pikëpamjet e ngritura në lidhje me një çështje?) Bëni përpjekje për konsensus.

Bashkëpunim

Identifikoni dhe diskutoni mbi vlerat dhe vizionet që duhet të udhëheqin shkollën tuaj. Nëse është e mundur, përpunoni të merrni një vendim unanim në lidhje me to. Kontribuoni në ndërtimin e një atmosfere besimi dhe krijoni mundësi dhe një kornizë për shkëmbimin e ideve dhe praktikave, si dhe të të menduarit, planifikimit dhe zbatimit në bashkëpunim.

Transparenca

Jini transparentë në lidhje me parakushtet, kufijtë dhe shtrirjen kur merrni vendime. Për shembull, merrni parasysh kushtet ligjore, buxhetore apo lokale. Artikuloni çështjet e tilla në mënyrë të qartë dhe shprehimisht. Sigurohuni që t'i informoni në mënyrë të vazhdueshme të gjithë të përfshirët, në lidhje me të gjitha çështjet e rëndësishme, dhe/ose ofrojuni qasje në informacionin përkatës.

Toleranca

Ne mund të ndihemi të kundërt me një person ose një grup njerëzish për arsye të ndryshme. Ata që kanë nivel të ulët tolerance, thjesht sjellen me shpërfillje ndaj të tjerëve. Një nivel më i lartë i tolerancës na lejon të zgjerojmë kufijtë e përvojës sonë përmes dialogut të plotë dhe përpjekjeve të ndershme për t'i kuptuar të tjerët. Mundohuni ta rritni nivelin tuaj të tolerancës kur përballeni me njerëz ose grupe njerëzish me të cilët ndiheni të kundërt.

Atmosfera shkollore

Siguroni një atmosferë pozitive, paqësore, ku të gjithë ndihen të sigurt, të respektuar dhe që i përkasin një komuniteti të mirëfilltë. Krijoni një atmosferë respekti dhe mirëkuptimi për njëri-tjetrin. Vendosni mënyra të institucionalizuara të zgjidhjes së konflikteve.

Ndarja e pushtetit

Qëndroni të gatshëm të ndani disa nga kompetencat tuaja dhe t'u delegoni përgjegjësinë të tjerëve. Sigurohuni që palët e interesuara të kenë fjalën e tyre për atë që bëjnë dhe si e bëjnë atë. Pranoni kritikën dhe përgatituni të kaloni nga kontrolli te besimi. Sigurohuni që rreziqet e mundshme të vendimeve të ndahen dhe që të gjithë ata që janë të përfshirë të jenë të vetëdijshëm për to.

Vendimmarrja

Analizoni parakushtet ligjore (mundësitë dhe kufizimet) për praktikën demokratike në shkollën tuaj. Paraqitni një kornizë për rregullat për vendimmarrje gjithëpërfshirëse (krijimi i strukturave dhe proceseve demokratike). Përfshini forma të shqyrtimit/diskutimit, votimit, përfaqësimit.

Respektoni vendimet demokratike si të detyrueshme dhe sigurohuni t'i vini në praktikë rezultatet e vendimmarrjes së përbashkët. Sigurohuni që vendimet të jenë legjitime në aspektin ligjor dhe moral.

Të gjithë duhet të kenë të njëjtën mundësi për të marrë pjesë në proces. Mbështeteni dhe fuqizoni grupet e cenueshme, të pafavorizuara dhe të marginalizuara.

Kur duhet caktuar detyrat dhe rolet, merrni parasysh preferencat dhe kompetencat e njerëzve.

Iniciativa

Nxitni dhe mbështetni iniciativat dhe siguroni fleksibilitet për të ndërmarrë veprime. Për aq sa është e justifikueshme, lejoni mundësi që të devijohet nga rregullat e përcaktuara dhe të siguroni hapësirë kreative për të provuar dhe gabuar.

Burimet

Siguroni dhe mbani burime për praktikën demokratike (kohë, informacion, mbështetje institucionale).




Pjesëmarrja

Merrni në konsideratë palët e interesit

Nëse keni ndërmend të praktikoni demokracinë pjesëmarrëse, është e nevojshme të parashikoni përfshirjen e grupeve të mundshme të njerëzve dhe rolet e tyre specifike. Për më tepër, nëse në vendin tuaj ekzistojnë ligje që u japin palëve të interesit të drejta specifike në vendimmarrje në shkollë, ose institucionet si këshilli i nxënësve ose një këshill i përbashkët shkollor (me mësues, prindër dhe nxënës) janë të përcaktuara me ligj, ju duhet t'i merrni parasysh këto dhe ta bëni shfrytëzimin më të mirë të mundshëm prej tyre.

Nxënësit...

...përbëjnë grupin kryesor të synuar, puna e të cilëve është të mësojnë dhe të veprojnë në mënyrë demokratike në shkollë. Ata mund të përfshihen në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit gjatë orëve të mësimi, në çështjet që kanë të bëjnë me të gjithë klasën (rregulla, udhëtimet e klasës, jetën shoqërore, etj ...), si edhe në çështjet e tërë shkollës, si infrastruktura, ngjarjet shkollore ose rregullat e shkollës. Për më tepër, nxënësit janë burim i vlefshëm për të gjitha përpjekjet për të reformuar dhe përmirësuar procesin mësimor në klasë, ose shkollën si tërësi. Për më tepër, atyre mund t'u mësohet demokracia në mësim të ndryshme bazuar në materialet mësimore nga kjo ueb faqe, Demokracia në veprim.



Prindërit...

...janë përgjegjës për fëmijët e tyre. Si të tillë, ata kanë një rol të madh në edukimin e fëmijëve të tyre. Nuk ka arsimim të suksesshëm në shkollë pa mbështetje dhe bashkëpunim prindëror. Kjo është arsyeja pse përfshirja e prindërve është thelbësore. Prindërit mund të përfshihen në mënyra të ndryshme. Epstein sugjeron forma të përfshirjes së prindërve, të tilla si të treguarit prindërve se çfarë mund të bëjnë në shtëpi për të mbështetur përparimin e nxënësve të tyre në shkollë, ose informimin e rregullt të prindërve për fëmijët e tyre dhe programin shkollor. Prindërit gjithashtu mund të jenë vullnetarë në shkollë, p.sh. në ngjarjet shkollore ose ofrimin e ndihmës tjetër. Më në fund, prindërit mund të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në shkollë.

Mësuesit...

...janë edukatorët kryesorë për nxënësit në shkollë. Mësimdhënia e tyre ndikon fuqimisht në atë se si dhe çfarë (mund të) mësojnë nxënësit. Mësuesit i dinë shumë mirë pikat e forta, problemet dhe karakteristikat personale të

nxënësve të tyre. Ata janë partnerët më të rëndësishëm për drejtorët. Një bashkëpunim i shëndoshë dhe i ngushtë midis drejtorit dhe mësuesve është thelbësor për sigurimin e kushteve të mira të mësimdhënies dhe të nxënësve. Takimet e rregullta midis drejtorëve dhe mësuesve (takimet e stafit) janë standarde në shumicën e shkollave. Në këto takime, ju mund të diskutoni në mënyrë të hapur rregulloret e reja nga autoritetet publike dhe të identifikoni implikimet e tyre për shkollën tuaj, të kuptoni qëndrimet dhe përvojat e mësuesve, të nxisni nisma, delegoni përgjegjësi, si dhe të përfshini stafin tuaj mësimdhënës në pothuajse çdo vendim që do të merret në shkollë.

Komuniteti...

...është konteksti social në të cilin shkolla juaj është e ngulitur. Ai përbëhet nga qytetarët e zakonshëm, shoqata publike dhe private, ndërmarrje dhe kompani, institucione të tjera arsimore publike, institucione publike të shëndetit dhe të sigurisë (spitale, polici etj), si dhe politikëbërës. Bashkëpunimi i ngushtë me këta aktorë u mundëson shkollave të ofrojnë shërbime të zgjeruara që u shërbejnë nevojave të nxënësve dhe prindërve. Duke përfshirë palët e komunitetit në vendimmarrjen shkollore, bëhet gjithashtu e mundur që programet e shkollës të përshtaten me nevojat e komunitetit. Për shembull, nëse policia raporton për një vandalizëm të rritur, ose mjekët janë të shqetësuar për rritjen e varësisë në komunitet ndaj videolojërave, shkollat mund të integrojnë diskutimin e çështjeve të tilla në programin ose kurrikulën e tyre.

Autoritetet publike...

...mbikëqyrin zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që janë të detyrueshme për shkollat. Ato monitorojnë shkollat përmes inspektimeve, vlerësimit dhe vëzhgimit të performancës së shkollës. Në përgjithësi, është e nevojshme të sigurohet që të gjitha vendimet e marra nga një shkollë janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale. Mbani përfaqësuesit e autoriteteve publike të informuar në lidhje me planet tuaja dhe, nëse është e mundur, përpikuni t'i përfshini ata në procesin e vendimmarrjes tuaj në një fazë të hershme. Ndërtimi i besimit do t'i bëjë ata më të disponuar të mbështesin idetë, vizionet dhe projektet tuaja.

Pjesëmarrja

Shkallët e pjesëmarrjes: Të munduarit për të qenë i sinqertë!

Sociologu Roger Hart shkroi një libër të quajtur Pjesëmarrja e fëmijëve: Teoria dhe praktika e përfshirjes së qytetarëve të rinj në zhvillimin e komunitetit dhe kujdesin mjedisor për UNICEF më 1997. Kjo qasje e vendosi punën e të rinjve dhe aleatëve të rritur në të gjithë botën në kontekstin e një lëvizjeje globale për pjesëmarrje. Ju ofron juve, mësuesve tuaj dhe prindërve një mundësi të mahnitshme: të jemi të sinqertë lidhur me mënyrën si i integrojmë fëmijët dhe të rinjtë në proceset e vendimmarrjes. Shumë shpesh, fëmijët në një skenë, gjatë një takimi në një ngjarje, dhe madje edhe në një shfaqje teatrale trajtohen si dekorim i thjeshtë, ose pakicat janë integruar si shenjë për të na bërë të ndihemi më mirë. (<http://www.freechild.org/ladder.htm>)

Nxënësit dalin me një nevojë apo një plan. Ata i bindin të rriturit që t'i përkrahin dhe/apo financojnë. Së bashku, ata vendosin dhe realizojnë planin.

8

Iniciuar nga nxënësit. Vendimet ndahen me të rriturit.

Nxënësit e kanë një ide dhe flasin për të. Ata e marrin iniciativën dhe e sjellin planin e tyre deri të rezultati.

7

Iniciuar dhe drejtuar nga nxënësit.

Një oborr i ri shkollor është planifikuar. Nxënësit jo vetëm që janë konsultuar, por mund edhe të vendosin për disa nga hollësitë.

6

Iniciuar nga të rriturit. Vendimet ndahen me nxënësit.

Para se të merret vendimi, të rriturit konsultohen me nxënësit. Pikëpamjet dhe propozimet e tyre merren në konsiderim.

5

Nxënësit janë të konsultuar dhe të informuar.

Një detyrë (për shembull një punë komunitare) u është dhënë nxënësve pa pasur mundësi të zgjedhin të pajtohen apo mospajtohen. Po ata janë të informuar dhe e dinë kauzën.

4

Nxënësve u është caktuar detyra nga dikush tjetër, por janë të informuar.

Një grupi të përzgjedhur nxënësish (ndoshta një pakice) i jepet mundësia për të prezantuar "kauzën e tyre" pa shprehur mendimin e tyre, pa përgatitje. Ata shërbejnë për ta treguar korrektësinë politike.

3

Përfaqësim sipërfaqësor: Integrim simbolik (i minoriteteve).

Nxënësit janë përgatitur që të shfaqen ndoshta në kostume duke bartur lule e flamuj. Ata bëjnë që një ngjarje e të rriturve (qoftë dhe dita e të drejtave të fëmijëve) të duket bukur dhe miqësore për nxënësit.


2

Dekor: nxënësit janë të shfrytëzuar

Nxënësit janë pjesë e një ngjarjeje politike. Ata mund të bartin afishe me parulla. Ata janë të veshur në ngjyrat e partisë apo lëvizjes.

1

Manipulum: Nxënësit janë të keqpërdorur.



Pjesëmarrja

Fusha të rëndësishme të veprimit

Seksioni “Përgatitja” ju ofron katër butona që ju dërgojnë në pyetësorë të ndryshëm për të reflektuar mbi fushat e rëndësishme të veprimit në lidhje me praktikën demokratike në shkollë.

1. Përfshirja e nxënësve, prindërve dhe komunitetit
2. Mësuesit dhe drejtorët (praktika dhe bashkëpunimi)
3. Vendimmarrja, komunikimi dhe fuqia
4. Atmosfera e shkollës, transparenca dhe iniciativa


Këta pyetësorë mund të përdoren në mënyra të ndryshme për të marrë një pasqyrë të qartë të një pike filletare të mundshme për veprim në shkollën tuaj.

Mundësitë për të punuar me materialet e mëposhtme

- a) Plotësoni të gjithë pyetësorët vetë si drejtor dhe zbuloni se cilat fusha të veprimit janë të suksesshme dhe cilat kërkojnë mbështetje dhe zhvillim shtesë në shkollën tuaj.
- b) Lejoni personelin e shkollës t’i plotësojë pyetësorët dhe analizoni ata së bashku. Pastaj, ju e filloni një diskutim mbi bazën e rezultateve. Mundohuni të kuptoni më mirë se çfarë ju befason apo godet. Duke vepruar kështu, krijoni një listë të prioriteteve të fushave të veprimit për praktikën e demokracisë në shkollën tuaj.
- c) *Shënim:* Në seksionin «listat e kontrollit, planet e veprimit dhe metodat» ka një përshkrim të një mjeti falas të anketimit në internet (i drejtuar nga Google). Ju mund t’i kopjoni pyetjet në këtë mjet dhe të filloni një studim në internet (online) me mësuesit tuaj. Sistemi i paraqet menjëherë rezultatet, të cilat mund të diskutohen më tej me mësuesit tuaj.
- d) Përdorni pyetësorin ose disa pyetje nga aty si bazë për vëzhgime. Informuohuni deri në detaje me praktikën e tanishme në shkollën tuaj dhe në klasë. Ju mund të bëni vëzhgime të rregullta gjatë një periudhe kohe për të mbledhur më shumë informacion. Kontrolloni pyetësorin me stafin tuaj nëse është e nevojshme.
- e) Ju mund të zgjidhni fusha specifike të veprimit ose pyetje nga pyetësorët. Përdorni ato si një pikënisje për diskutime me stafin mësimor dhe për të rritur ndërgjegjësimin për një çështje specifike.

Shënim 1: Në vend që të zgjidhni vetëm një variant, ju mund të kombinoni edhe disa variante. Për shembull, ju mund të plotësoni vetë pyetësorët, pastaj të bëni një studim me mësuesit, ndjekur nga një diskutim i rezultateve. Më në fund, ju vëzhgoni dhe mblidhni informacione rreth aspekteve specifike në shkollën tuaj.

Shënim 2: Për ndihmë për punën në fushat e veprimit që keni identifikuar për shkollën tuaj, këshillohuni me seksionin “veprimi”.



Pjesëmarrja

Reflektim mbi mundësitë e pjesëmarrjes

	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
NXËNËSIT: Në shkollën tonë...				
...nxënësit janë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes shkollore, p.sh. rregullat, programi, ngjarjet, infrastruktura, reforma, etj.				
... janë të institucionalizuara organet përfaqësuese të nxënësve, p.sh. parlamenti i nxënësve, këshilli i nxënësve në nivel shkolle, këshilli i nxënësve në nivel klase, etj.				
NXËNËSIT: Në orët mësimore ... (Shënim: Nëse jeni mësues, ju lutemi referojuni përvojës suaj të mësimdhënies!)				
...nxënësit mësojnë shprehimisht për demokracinë, p.sh. në EQD/EDNJ.				
...nxënësit praktikojnë shprehimisht demokracinë.				
...nxënësit janë në gjendje të ofrojnë informata kthyese.				
... nxënësit janë në gjendje të zgjedhin kur t'i kryejnë cilat lloje detyrash.				
...nxënësit janë në gjendje të zgjedhin ku të punojnë (hapësirën apo këndin në klasë).				
...nxënësit janë në gjendje të zgjedhin me kë të punojnë.				
...mësuesit u caktojnë nxënësve detyra që mund të zgjidhen në mënyra të ndryshme.				
...mësuesit u caktojnë nxënësve detyra që lejojnë rezultate të ndryshme, si p.sh. zgjidhje.				
...nxënësit janë të përfshirë në përcaktimin e rregullave.				
...nxënësit informohen vazhdimisht për pikat e tyre të forta dhe të dobëta.				
...mësuesit u ofrojnë mundësi nxënësve ta vlerësojnë veten.				
...nxënësit janë të informuar mirë se pse e marrin notën e caktuar.				

PRINDËRIT				
Prindërit rregullisht informohen për progresin e fëmijëve të tyre.				
Prindërit rregullisht informohen për programet e shkollës.				
Prindërve u kërkohet të ndihmojnë vullnetarisht.				
Prindërve u tregohet se çfarë mund të bëjnë në shtëpi për ta përkrahur progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.				
Shkolla jonë i përfshin prindërit në vendim-marrjen shkollore, p.sh. rregullat, programet, ngjarjet, reformat, etj.				
Në shkollën tonë janë të institucionalizuara organet përfaqësuese të prindërve si p.sh. këshilli i prindërve.				



Pjesëmarrja

Reflektim mbi pjesëmarrjen e mësuesve dhe komunitetit

	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
DREJTORËT DHE MËSUESIT				
Në shkollën tonë janë të institucionalizuara terminet për mësuesit që të punojnë rregullisht së bashku, p.sh. grupet punuese të mësuesve.				
Ne ndjekim vlerat e përbashkëta dhe vizionet në punën tonë në shkollë.				
Ekziston një shkallë e lartë e besimit ndërmjet anëtarëve të stafit.				
Shënim: Nëse jeni mësues, ju lutemi referojuni praktikës ose përvojës suaj!				
Mësuesit e përdorin materialin e mësimdhënies mbi EQD/EDNJ prej Këshillit të Evropës, të ofruar në këtë ueb faqe.				
Mësuesit kanë shumë liri të vendosin për vetveten se çfarë të bëjnë.				
Mësuesit e ndajnë dijen, përvojën dhe praktikën më të mirë me njëri-tjetrin.				
Mësuesit bëjnë përpjekje të konsiderueshme për t'u ofruar mësim adekuat nxënësve me vështirësi kulturore, njohëse, fizike, etj.				
Mësuesit janë të gatshëm për t'ua përshtatur mësimdhënien e tyre nevojave të nxënësve të tyre.				
Mësuesit janë në dialog të përhershëm me njëri-tjetrin.				
Mësuesit i ndajnë informatat, idetë, përvojat, dijen, materialet mësimore dhe praktikat më të mira me njëri-tjetrin.				
Mësuesit i vëzhgojnë orët mësimore të njëri-tjetrit dhe ofrojnë informata kthyesë për njëri-tjetrin.				
Mësuesit punojnë së bashku me kolegët e tyre për t'i përgatitur mësimet apo për të provuar ide të reja.				
Mësuesit merren vesh për përmbajtjen mësimore dhe kriteret e testeve apo vlerësimit.				

KOMUNITETI				
Shkolla jonë bashkëpunon me komunitetin e gjerë për të ofruar shërbime shtesë.				
Shkolla jonë bashkëpunon me komunitetin e gjerë për t'i përshtatur programet e saj me nevojat e komunitetit.				

Pjesëmarrja

Reflektim mbi klimën, transparencën dhe iniciativën

	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
KLIMA E SHKOLLËS				
Në shkollën tonë nxënësit ndihen rehat.				
Në shkollën tonë nxënësit ndihen të sigurt.				
Në shkollën tonë nxënësit ndihen të respektuar.				
Në shkollën tonë mësuesit ndihen rehat.				
Në shkollën tonë mësuesit ndihen të sigurt.				
Në shkollën tonë mësuesit ndihen të respektuar.				
Në shkollën tonë ekziston një klimë mirënjohëse.				
Në shkollën janë të institucionalizuara strategjitë për zgjidhjen paqësore të konflikteve.				
TRANSPARENCA				
Drejtori ndan në mënyrë të hapur informata për stafin, dhe ofron qasje në to.				
Drejtori i komunikon në mënyrë të qartë ligjet, rregulloret, pritjet dhe mundësitë për mësuesit.				
Drejtori e tregon në mënyrë të hapur opinionin e tij para mësuesve.				
Drejtori rregullisht jep informata mbi rrethanat, faktet, proceset apo vendimet lidhur me shkollën.				
INICIATIVA				
Në shkollën tonë mësuesit dhe nxënësit inkurajohen të ndjekin idetë dhe t'i vënë ato në praktikë.				
Në shkollën tonë inkurajohen mendimi kritik dhe novacioni.				

Pjesëmarrja

Reflektim mbi vendimmarrjen, komunikimin dhe fuqinë

Shënim: Për këshilla se si të përdoret ky pyetësor shkoni te “përgatitja: fusha të rëndësishme veprimi”

	Po	Pjesërisht	Jo	Komente
Kur merren vendime në shkollën time...				
...drejtori i përfshin të gjitha palët që ndikohen nga vendimi (mësuesit, prindërit, nxënësit)				
...njerëzit e pafavorizuar dhe të marginalizuar inkurajohen dhe përkrahen për t'u përfshirë.				
...anëtarët e stafit dëgjojnë aktivisht dhe përpiqen të kuptojnë njëri-tjetrin.				
...anëtarët e stafit përpiqen ta bindin njëri-tjetrin përmes argumentimit logjik dhe të kuptueshëm.				
...anëtarët e stafit, në mënyrë të hapur pyesin dhe përgjigjen në pyetje.				
...anëtarët e stafit i zbulojnë dhe i reflektojnë në mënyrë të ndershme qëndrimet, supozimet dhe ndjenjat individuale.				
...merren parasysh pikëpamjet e ndryshme të palëve të interesit.				
...ne përpiqemi ta arrijmë të kuptuarit e përbashkët dhe konsensusin.				
kur drejtori u cakton detyra njerëzve, preferencat dhe kompetencat e tyre merren parasysh.				
Në shkollën time...				
...mbledhja e informatave kthyesë është praktikë e përbashkët.				
...ekzistojnë rregullore të shkruara për parimet e detyrueshme të strukturave dhe proceseve demokratike.				
... i kushtohet kohë shqyrtimit të kujdesshëm dhe marrjes së vendimeve të përbashkëta.				
...drejtori është në dialog të përhershëm me stafin.				

...të gjithë njerëzit (apo grupet e njerëzve) të prekur përfshihen në vendimmarrje.				
...njerëzit rregullisht kanë mundësi të votojnë (çojnë duart, shënojnë opsionet, etj)				
...ekzistojnë përfaqësuesit e zgjedhur që ve-projnë për interesin e grupeve të njerëzve.				
...drejtori i komunikon qartë shtrirjen dhe kufizimet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të sjella nga autoritetet publike.				
FUQIA				
Drejtori i përkrah vendimet demokratike edhe nëse nuk i reflektojnë preferencat e tij/saj individuale.				
Drejtori e pranon kritikën konstruktive.				
Drejtori e ndan përgjegjësinë me të tjerët.				
Në shkollën time, të gjithë ndihemi të përgjegjës si për sukseset, ashtu edhe për gabimet.				

*Pjesëmarrja***Procesi pesëhapësh për veprimin pjesëmarrës**

Procedura e mëposhtme me pesë hapa ilustron një proces ideal për veprim pjesëmarrës, demokratik që mund ta aplikoni në shkollën tuaj (bazuar në Fung 2004). Në këtë procedurë mund ta përfshini stafin por edhe nxënësit, prindërit dhe të tjerët që janë prekur nga çështja që do të vendoset.

- 1. Përcaktimi i agjendës (Identifikimi se çfarë do të veprohet):** Çështja për të cilën duhet të veprohet mund
 - a) të përket me implikimet e ligjeve dhe rregulloreve të përcaktuara nga autoritetet e shkollës,
 - b) të përket me pikëpyetjet, shqetësimet ose problemet në shkollë,
 - c) ose thjesht të përcaktohen hapur së bashku.
- 2. Diskutim dhe propozim:** Sugjerimi, arsyetimi dhe diskutimi i alternativave, propozimeve dhe strategjive për ta adresuar çështjen; Kjo fazë rezulton me një plan veprimi i cili duhet të përmbajë:
 - a) detyrat konkrete që duhen realizuar,
 - b) caktimin e detyrave njerëzve,
 - c) pritjet për atë që detyrat do të përmbushin sipas çështjes në fjalë, dhe
 - d) metodat e vlerësimit për të vlerësuar nëse janë realizuar detyrat dhe nëse janë arritur efektet e dëshiruara.
- 3. Veprimi:** Njerëzit përpiqen ta ndjekin planin e veprimit dhe t'i kryejnë detyrat.
- 4. Vlerësimi:** Pasi të ketë përfunduar veprimi, njerëzit diskutojnë se si funksionuan gjërat. As rezultati i hapit 1 dhe as rezultatet e hapave 2 dhe 3 nuk mund të sigurojnë mënyrën më të mirë të marrjes me rregulloret, zgjidhjen e një problemi, trajtimin efektiv të një shqetësimi ose përgjigjen e përsosur për një pyetje. Detyrat e zhvilluara bashkërisht në hapin 2 shprehin pritjet dhe veprimet e kryera në hapin 3 janë eksperimentale. Vlerësimi jep informacion në lidhje me rezultatet e atyre eksperimenteve.
- 5. Rinisja:** Sipas rezultateve të vlerësimit, procedura mund të përfundojë ose të fillojë përsëri nga fillimi. Nëse është e nevojshme, rimendoni të gjitha shqetësimet dhe strategjitë për të rritur mundësinë e rezultateve më të mira.

Pjesëmarrja

Këshilli i klasës

Këshillat e klasave zakonisht zhvillohen një herë në javë në çdo klasë të një shkolle.

Këshilli i klasës është një strukturë e institucionalizuar që ua mundëson nxënësve t'i artikulojnë shqetësimet e tyre dhe t'i diskutojnë ato me mësuesit dhe shokët e shoqet e klasës. Zakonisht, ekziston një kushtetutë e shkruar e keshillit të klasës për t'i përcaktuar tiparet kryesore dhe kushtet themelore. Ju mund ta krijoni një kushtetutë të tillë së bashku me stafin dhe ta përdorni planin e veprimit në këtë seksion për ta lehtësuar zbatimin e keshillit të klasës hap pas hapi. Si një drejtor me mendësi demokratike, ju jeni të interesuar t'i keni këto këshilla në çdo klasë. Sigurohuni që mësuesit të jenë të përgatitur mirë për to. Përgatitni një sesion trainimi në shkollën tuaj me një grup mësuesish të përkushtuar për ta mbështetur përpjekjen tuaj. Informacioni i mëposhtëm duhet të ndahet nga të gjithë:

Komponentët kryesorë të këshillave të klasave:

- Gjetja dhe mbledhja e çështjeve për t'i diskutuar (konfliktet, infrastruktura, udhëtimet shkollore, rregullat, mësimdhënia, etj.); nxënësit mund t'i rendisin shqetësimet e tyre në një dosje të keshillit të klasës ose t'i postojnë ato në një kuti letrash që janë përherë të arritshme.
- Miratimi i roleve dhe funksioneve, p.sh. kryetari, nënkryetari, kryesuesi, procesmbajtësi, kohëmbajtësi. Të gjitha rolet praktikohen në fillim me ndihmën e mësuesit / mentorit.
- Qëllimi: Mentori / mësuesi gradualisht tërhiqet, dhe nxënësit menaxhojnë vetë

Një sesion i keshillit të klasës - udhëzues hap pas hapi:

Përgatitja e sesioneve të keshillit të klasës:

- Para sesioneve: regjistrohen temat/çështjet që do të diskutohen (mbledhja e temave).
- Përgatitet procesverbali i sesionit të fundit dhe shablloni i procesverbalit për sesionin tjetër.
- Rregullohen karriget në formë rrethi dhe sigurohet materiali.
- Zgjidhet kryetari për këtë ditë (mbase tashmë për të gjithë semestrin).

Hyrja:

Këshilli i klasës mund të fillojë me fjalën mirëseardhëse nga kryetari, një shprehje e mirënjohjes reciproke ose e dëshirave.

Kontrolloni vendimet nga sesioni i fundit:

Këshilli i kontrollon vendimet, mbledh vendimet dhe mbase i integron disa çështje në listën e temave.

Sqaroni procesverbalin për sesionin:

Këshilli kontrollon listën aktuale të temave.

- A janë temat ende urgjente? A ka ende nevojë të diskutohen?
- A ka çështje të reja / çështje urgjente?
- A ka ndonjë gjë tjetër për t'u informuar, diskutuar apo për të vendosur?

Diskutoni shqetësimet/zgjidhni konfliktet:

Nxënësit shprehin shqetësimet e tyre, kërkojnë zgjidhje dhe konsiderojnë sugjerime. Nxënësi që paraqet një temë fillon me shpjegimin e shqetësimit. Nxënësit e tjerë marrin informacion dhe bëjnë pyetje përcjellëse për ta kuptuar plotësisht çështjen, shprehin argumente dhe mbledhin sugjerime (në grupe të vogla ose në sesion plenar).

Marrja e vendimeve:

Pas debatit dhe diskutimit të një çështjeje, duhet të ketë një vendim të përbashkët (përmes votimit ose gjetjes së kosensusit) dhe një procedurë për udhëheqjen e procesit.

Regjistrimi i vendimeve:

Vendimet regjistrohen dhe ruhen si dokumente në dosjen e këshillit të klasës. Pas një kohe, këshilli i klasës duhet të kontrollojë nëse vendimet janë realizuar (pse, pse jo).

Reflektim dhe informata kthye lidhur me sesionin:

Nxënësit reflektojnë për përvojat e tyre në këshillin e klasës dhe pyesin veten se çfarë funksionoi mirë/jo mirë, dhe çfarë mund të ndryshojnë individualisht dhe së bashku.

Mbyllja e seancës:

Kryetari paraqet edhe një herë vendimet, sqaron çështjet organizative, etj.

Reflektim për sesionet e këshillit të klasës:

Mentori reflekton mbi këshillin e klasës me nxënësit dhe performimin e detyrave nga ana e tyre (kryesues, regjistruer, etj) dhe zbulon nëse nxënësit ende kanë nevojë për mbështetje në aspekt të kryesimit ose udhëheqjes së këshillit, dhe shqetësimeve dhe sugjerimeve të tjera.

Pjesëmarrja

Metodat - mbledhja, grupimi, caktimi i përparësive, votimi, kërkimi i konsensusit

Mbledhja dhe grumbullimi

Në një proces të vendimmarrjes demokratike, mund të lindin shumë pikëpamje, sugjerime dhe ide. Kështu, kryesuesi duhet t'i përpunojë këto çështje dhe t'i grupojë ato. Kjo mund të arrihet në sesione plenare, duke shënuar ato në tabelë ose letër kur pjesëmarrësit ngritin pikat e tyre. Në punë grupore, pjesëmarrësit mund t'i shkruajnë pikat e tyre në fleta dhe t'i prezantojnë ato. Pasi të jenë ngritur dhe diskutuar të gjitha pikat, është e nevojshme të grupohen aspektet e mbivendosura dhe të dallohen qartë ato nga njëra-tjetra.

Votimi dhe caktimi i përparësive

Votimi është procedura tipike për të marrë një vendim demokratik, përmes së cilës shumica zakonisht përcakton rezultatin. Ekzistojnë procedura të ndryshme të votave të shumicës.

Ne jemi më të njohur me votimin duke ngritur duart ose duke shënuar një nga disa opsione në fletëvotim. Një mënyrë e dobishme për të votuar pas mbledhjes dhe grupimit të disa pikëpamjeve, ideve ose sugjerimeve nga një audiencë është shpërndarja e një numri pikash ngjitëse me ngjyra për secilin person. Pjesëmarrësit pastaj i vendosin pikat e tyre në opsionet e tyre të preferuara në një formular. Ata mund të përdorin të gjitha pikat për një opsion ose t'i shpërndajnë ato për shumë opsione. Ju gjithashtu mund të caktoni një kufi prej tri pikash për një opsion, nëse kjo ka kuptim. Është e rëndësishme të pranohet që pjesëmarrësit mund të ndikojnë reciprokisht mbi njëri-tjetrin kur të shohin se për çfarë votojnë të tjerët, p.sh. kur ngrisin duar ose vendosin hapur pikat për opsione të caktuara. Për të parandaluar manipulimet e ndërsjella, është e mundur t'u kërkoni pjesëmarrësve të mbyllin sytë përpara se të ngrenë duart, ose t'u shpërndahen gurë të vegjël pjesëmarrësve dhe t'u kërkohet atyre t'i hedhin ata në kutitë pranë opsioneve të dhëna. Procedurat e fundit janë treguar veçanërisht të dobishme kur punoni me fëmijë të vegjël, të cilët priren të shohin se çfarë bëjnë të tjerët përpara se të mendojnë për vete.

Kërkimi i konsensusit

Votat e shumicës gjithnjë prodhojnë fitues dhe humbës. Kur votoni për çështje të caktuara, është e nevojshme të mbani në mend se humbësit e mundshëm gjithashtu duhet të marrin pjesë në zbatimin e vendimit. Kjo është arsyeja pse dikush duhet të përpiqet të përfshijë interesat e tyre nëse është e mundur, p.sh. përmes kompromisit. Një mënyrë e kërkimit të një konsensusi të tillë është të ofroni katër opsione për të cilat pjesëmarrësit mund të votojnë. Është provuar të jetë motivuese kur këndet në dhomë paraqesin mundësi të ndryshme (mund të shënoni këndet me posterë të vegjël) dhe pjesëmarrësit lëvizin në këndet që zgjedhin.

Opsionet:

1. Pajtohem plotësisht
2. Kam disa dyshime për këtë, por marr pjesë aktive në zbatimin e tij.
3. Unë nuk mund të pajtohem me të në këtë formë. Duhet të ndryshojmë diçka (p.sh. në formulim).
4. Nuk pajtohem aspak (veto)

Nëse një person voton për opsionin 3, grupi duhet ta ndryshojë dhe ta përmirësojë propozimin aktual. Nëse një person voton për opsionin 4, propozimi është hedhur poshtë. Përparësia e kësaj procedure është se askush nuk mund të tërhiqet nga vendimmarrja ose të injorohet. Të gjithë duhet të dalin me një deklaratë dhe të marrin hapur një pozicion. Kur aplikohet kjo metodë me fëmijë (të vegjël) vetëm dy mundësi duhet të ofrohen në fillim - "pajtohem" dhe "nuk pajtohem (veto)". Nëse vetëm një fëmijë nuk pajtohet, fëmijët duhet të kërkojnë një zgjidhje të re.

*Pjesëmarrja***Metodat – Zgjidhja e konflikteve, kafeneja e botës (World Café), forumi i diskutimit****Zgjidhja e konflikteve:**

Konfliktet midis personave ose grupeve të personave duhet të trajtohen në mënyrë sistematike. Ato ofrojnë mundësi të rëndësishme të të nxënësve në qytetarinë demokratike, pasi nxënësit mund të mësojnë se konfliktet i përkasin jetës shoqërore, por mund të zgjidhen duke marrë parasysh interesat e të dyja palëve.

Një procedurë standarde për zgjidhjen e konflikteve (zakonisht e aplikuar me nxënësit):

1. I gjithë grupi merr miratimin nga palët kundërshtarë për ta zgjidhur konfliktin e tyre.
2. Konflikti përshkruhet nga çdo person i përfshirë në konflikt.
3. Konflikti analizohet dhe interesat dhe nevojat sqarohen.
4. Grupi përpiket t'i ndryshojë këndvështrimet dhe tregojnë empati me të gjitha palët në konflikt.
5. Grupi kërkon zgjidhje (p.sh. përmes stuhisë së mendimeve)
6. Personat e përfshirë në konflikt i konsiderojnë zgjidhjet (të dobishme, të realizueshme) dhe zgjedhin disa.
7. Personat e përfshirë në konflikt arrijnë marrëveshje.
8. Personat e përfshirë në konflikt (me ndihmën e grupit) planifikojnë si ta zbatojnë marrëveshjen (kush, çfarë, kur, si)

Kafeneja e botës:

Kafeneja e botës (ang. World Café) është një metodë për ta drejtuar një dialog të madh në grup dhe mund të jetë e dobishme për një sërë nevojash. Kjo metodë është e përshtatshme për zgjidhjen e problemeve të vështira ose përgjigjen e pyetjeve komplekse së bashku me shumë njerëz. Nxit përdorimin e inteligjencës kolektive dhe mbështet shprehjen e mendimeve, ideve ose zgjidhjeve të ndryshme. Ueb faqja (www.theworld-cafe.com) ju ofron të gjitha informatat e nevojshme për metodën.

Forumi i diskutimit:

Kjo metodë është vërtetuar të jetë e përshtatshme për nxënësit, por mund të aplikohet edhe me të rriturit. Ajo synon të zhvillojë të kuptuarit e thellë të një çështjeje dhe të demonstrojë një ndryshim të mundshëm në qëndrimeve pas diskutimit. Së pari, ju shpërndani një pyetësor të shkurtër (zakonisht me pyetje të mbyllura) për pjesëmarrësit, duke kërkuar të ofrojnë qëndrimet e tyre rreth çështjes në fjalë, p.sh. integrimi i refugjatëve. Në hapin e dytë, pjesëmarrësit marrin informacion të balancuar mirë në lidhje me çështjen. Në një sesion plenar (hapi i tretë), ekspertë dhe grupe të ndryshme të interesit nga komuniteti shkollor mund të ftohen të paraqesin para pjesëmarrësve argumentet dhe qëndrimet e tyre. Hapi i katërt: pjesëmarrësit janë të ndarë në grupe të ndryshme dhe zhvillojnë pyetje për t'ua shtruar politikanëve nga parti të ndryshme. Hapi i pestë: në një sesion të dytë plenar, politikanët mund të reagojnë ndaj pyetjeve brenda një afati të caktuar kohor. Në fund, çdo pjesëmarrës e plotëson pyetësorin që nga fillimi, përsëri. Pyetësorët janë anonimë, por të shënuar me një kod. Në këtë mënyrë, është e mundur të tregohen ndryshimet në qëndrimin e njerëzve.

Shënim: Nëse nuk arrini të organizoni çdo hap, p.sh. të ftuarit e gjithë ekspertëve ose politikanëve, ju mund të kapërceni ose ndryshoni një hap, për shembull duke zëvendësuar ekspertët me pjesëmarrës. Këta pjesëmarrës duhet të informohen në detaje për një çështje, ose të marrin pozicionin e një grupi të caktuar interesi).

*Pjesëmarrja***Metodat – sondazhi i opinionit, informatat kthyesë, vlerësimi**

A doni të mbledhni informata kthyesë për një çështje specifike ose të bëni një vlerësim? A doni të mbledhni opinione ose informata më të hollësishme nga njerëzit? A doni të mundësoni pjesëmarrjen e grupeve më të mëdha të njerëzve dhe të përcaktoni përparësitë?

Pse të mos e hartoni një pyetësor dhe ta bëni një sondazh? Jini të qartë për llojin e informacionit që doni të merrni. Ju mund të gjeni shumë këshilla dhe shembuj në internet në lidhje me pyetjet që duhet t'i përfshini në një pyetësor për informata kthyesë, vlerësim ose mbledhje të opinioneve, etj. Të tilla janë faqet zyrtare të arsimit të vendit tuaj, ueb faqet e mësuesve, etj. Ju gjithashtu mund t'i krijoni vetë pyetjet tuaja individuale. Përgjithësisht, pyetësorët pranohen më lehtë nëse hartohen së bashku me përfaqësuesit e njerëzve që do të pyeten.

Mund të përdorni disa lloje pyetjesh, si

1. pyetje të hapura: njerëzit mund të përgjigjen me fjalët e tyre ose
2. pyetje të mbyllura: njerëzit përzgjedhin nga përgjigjet e dhëna

Mundohuni ta mbani pyetësorin sa më të shkurtër që të jetë e mundur (së shumti 4 faqe) dhe shprehni pyetjet qartë dhe në mënyrë specifike. Kini një ide të qartë për çfarë do të përdoren rezultatet e sondazhit.

Një studim në internet (online) ju lejon të analizoni rezultatet në mënyrën më efektive. Ju merrni automatikisht rezultatet posa njerëzit t'i kenë plotësuar pyetësorët. Format e Google (google drive) është një mjet falas në internet që mund ta përdorni (www.drive.google.com). Për përdorim, duhet vetëm ta hapni një llogari falas në Google, nëse akoma nuk keni një të tillë (<https://accounts.google.com>). Ju mund të gjeni disa video mësimore në internet (p.sh. në youtube kërkoni për: studime përmes formave të google, ose anglisht google forms survey) të cilat ju japin informacionin e nevojshëm për ta përdorur mjetin. Shikojini ato dhe provojeni vetë.

Këtu keni disa informacione themelore mbi format e Google që mund t'ju interesojnë:


- Ju mund të zgjedhni si t'i ftoni pjesëmarrësit e mundshëm të marrin pjesë në studim përmes:
 - a) dërgimit të e-mailit.
 - b) kopjimit dhe kalimit të një vegëze (link) dhe dërgimit të vegëzës te pjesëmarrësit.
- Anonimati sigurohet edhe nëse njerëzit futen në llogarinë e tyre të Google. Organizatori i një sondazhi nuk e sheh se kush është përgjigjur. Kjo mund të tregohet lehtësisht në internet me një projektor dixhital.
- Ju mund t'i analizoni të dhënat me një klikim të shpejtë në një buton në ekran dhe t'i shtypni rezultatet (përfshirë grafikët).
- Ju keni shumë mundësi për pyetje (zgjedhje e shumëfishtë, vlerësim me shkallë, pyetje të hapura, etj.).
- Mund t'i eksportoni të dhënat në excel.

PE SË HAPAT THEMELORË TË PJESËMARRJES


NE VENDOSIM
BASHKË




NE I PLANIFIKOJMË DHE I
ZBATOJMË GJËRAT SË BASHKU



NE INDAJMË DHE I
DISKUTOJMË IDETË



NE E INFORMOJMË
NJËRI-TJETRIN





REAGUESE

UNË REAGUJ NDAJ
GJËRAVE QË NDODHIN
DHE THEM DIÇKA KUR
GJËRAT SHKOJNË KEQ,
OSE KUR SHKOJNË MIRË

E PËRGJEGJSHME

UNË PËRGJIGJEM KUR
PYETEM PËR PIKËPAMJEN
APO MENDIMTIM

**PJESËMARRJA
E KOMUNITETIT**

GJENERUESE

UNË GJENEROJ
PROJEKTE, ORGANI-
ZIME APO INICIATIVA,
KUR SHOH SE DIÇKA
MUNGON

ANGAZHUESE

UNË I ANGAZHOJ,
NXIS, LIDH APO
INKURAJOJTË
TJERËT

STRATEGJIKE

UNË FUNKSIONOJ NË
NIVEL STRATEGJIK DHE
NDIKOJ NË POLITIKA,
PROJEKTE APO
ORGANIZATË

MBËSHETËSE

UNË I MBËSHTET
PROJEKTET DHE SKEMAT
QË JANË DUKE
NDODHUR

NDIHMUESE

UNË NDIHMOJ
DUKE BËRË GJËRAT

PRIORITETET E

PJESËMARRJES



TË NDIERTIR MIRË


VLERËSIMI, REZULTATI,
MONITORIMI, PROCEDURA E
ANKESAVE

**TË BËRIT
E PUNËS
SI DUHET**

TRAJNIMI I STAFIT, MBIKËQYRJA DHE
VLERËSIMET, REKRUTIMI

**TË
ADMINISTRUARIT
E SHËRBIMIT MIRË**

AUTORIZIMI, NDIKIMI NË
MENAXHERËT E LARTË, DEKLARATA
EMISIONIT



SA JEMINE
PJESËE
PROJEKTEVE?

NE KEMI NJË PLAN

TË RRITURIT VENDOSIN DHE
PUNOJNË SË BASHKU ME NE

NE VENDOSIM DHE E
BËJMË VETË

NE VENDOSIM SË
BASHKU META

ATA I DËGJOJNË IDETË TONA
DHE NA INFORMOJNË

ATA NA INFORMOJNË DHE NA
TREGOJNË ÇFARË TË BËJMË

DISA NGA NE JANË ZGJEDHUR
TË BËJNË ATË QË VENDOSIN
ATA

NE E LUAJMË ROLIN E
DEKORIT TË LUMTUR

ATA NA SHFRYTËZOJNË QË
TA BËJNË TË DUKET MIRË

NE KEMI
NJË PLAN

TË RRITURIT
KANË NJË PLAN

TË RRITURIT E KANË
NJË NGJARJE (PËR NE)

TË RRITURIT E KANË
NJË NGJARJE